



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



BASHKIA KORÇË
NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

(Pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit)

Nr. _____ prot.

Datë / /2026

Drejtuar: Subjektit “VASHTEMI” SHPK me Nr. NIPT J64103054Q, Korce Libonik
VASHTEMI Rruga Nacionale Korce Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona
kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6.

Operatorit Ekonomik (OE) X

ose Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës

PO JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedure e hapur e thjeshtuar

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-90554-06-18-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës

Objekti: “Blerje asfalt mikser dhe bitum per sperkatje”

Kohëzgjatja e kontratës/ ose afati për zbatimin e saj: 12 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:19.06.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 40 datë 22 Qershor 2026

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Subjekti “VASHTEMIA” SHPK me Nr. NIPT J64103054Q, me vlerën 6,657,200 (gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Subjekti “SARK” SHPK me Nr. NIPT K52531415H, me vlerën 8,146,000 (tetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit është s’kualifikuar, Ofertuesi i mëposhtëm:

1. Subjekti “SARK” SHPK me Nr. NIPT K52531415H, me vlerën 8,146,000 (tetë milionë e njëqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.

Referuar pikës 2.2.1 të Dokumenteve Standarde të Tenderit, ku është kërkuar që operatorët ekonomikë të paraqesin dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik SARK shpk rezulton se ai ka paraqitur si dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, kontratën e sipërmarrjes me Bashkinë Sarandë me afat përfundimi datë **12.06.2023**, si dhe faturat përkatëse të lëshuara në datë **14/06/2023**.

Duke qenë se njoftimi i kontratës për procedurën objekt vlerësimi është shpallur më datë **19.06.2026**, periudha e përcaktuar në DST për furnizimet e mëparshme të ngjashme përfshin intervalin kohor **19.06.2023 – 19.06.2026**.

Për rrjedhojë, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik, nuk rezulton të jetë i kryer brenda periudhës trevjeçare të përcaktuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit. Në keto kushte dokumentacioni i paraqitur jashtë periudhës së përcaktuar nuk mund të konsiderohet si provë për përmbushjen e kriterit të kapacitetit teknik.

2. Referuar nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohen kapacitetet mbi të cilat mund të mbështetesh tek një operator ekonomik, konkretisht parashikohet se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Ndërsa në rregullat e prokurimit publik konkretisht në pikën 2 të nenit 90 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar qartë se:

“2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet: - ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;”

Akoma më tej në pikën 4 të nenit 90 të aktit nënligjor të sipërpërmendur është përcaktuar që:

“4. Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Operatori ekonomik **"SARK" sh.p.k.** nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit asnjë subjekt mbështetës për përmbushjen e kriterit lidhur me nyjën e prodhimit të asfaltit dhe formulën e përzierjes së asfaltit miks, sipas kërkesave të DST-së. Megjithatë ka paraqitur dokumentacion nga dy subjekte të ndryshme, këto nuk janë deklaruar si subjekte mbështetëse dhe nuk janë shoqëruar me formularët përkatës të vetëdeklarimit. Për rrjedhojë, dokumentacioni i tyre nuk mund të merret në konsideratë për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të kualifikimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“VASHTEMIA” SHPK** me **Nr. J64103054Q**, Korce Libonik VASHTEMI Rruga Nacionale Korce Pogradec, Km. i 7, 500 m majtas rruges nacionale, zona kadastrale nr.3716, nr.pasurie 686/5, 686/6, se oferta e paraqitur me vlerë **6,657,200 (gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind) lekë pa TVSH**, është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ILIRJAN DINELLARI